



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupstina Opstine
Municipal Assambly

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Fton

Të gjitha OJQ-të që merren me organizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Istogut që të aplikojnë me projekt-propozim për organizimin e Turnirit Ndërkombëtar në shah kushtuar "Tre Dëshmorëve të shkollës Shqipe". Në projekt propozim duhet të janë të përshkruara : Qëllimi, Objektivat, Aktivitetet dhe Buxheti .Projekti duhet të jetë sa më i specifikuar në përshkrim pra të ceken në detale pjesët e organizimit të këtij turniri . Shuma e mbështetjes financiare për organizimi e këtij turnir mund të jetë maksimum deri në 1500 euro.

Përparësi do të kenë ato Organizata që :

1. Kanë përvojë të dëshmuar në organizimin e aktiviteteve të tilla .
2. Që kanë bashkëpunim me një apo më shumë OJQ .
3. Përparësi do të kenë projektet të cilat e kanë përshkrimin e qartë dhe buxhetin e specifikuar.
4. Përparësi do të kenë organizatat që janë nga Komuna e Istogut . Projekt - propozimet do të vlerësohen nga komision .

Afati përfundimtar për dorëzimin e projekteve është 04.02.2020.

Projektet që aplikojnë pas këtij termini nuk do të shqyrtohen. Projektet duhet të dorëzohen në Kuvendin Komunal – Zyra nr 100.

Në Kopje fizike të bashkangjitur me projekt propozim duhet të jetë edhe certifikata – dëshmia e OJQ -se ,numri fiskal, kopja e letërnjoftimit,koja e kartelës bankare .

Njoftim - organizatori i këtij turniri duhet ti përmbahet rregullave të IKSHPK-së

Nëse keni nevojë për informata shtese na kontaktoni ne : 049-766-009